

Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare "MARKET EMMA" sh.p.k

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë , në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 , " Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723 , datë 03.05.2007 "Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare , me vullnetin e tij të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortaku i vetëm :

- XHEMAL BAJRAM QARRI me nënshtetësi Shqiptare dhe Nr. ID F90913029I , i lindur në 13/09/1959 në Tiranë dhe banues në Tiranë.

Krijon shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "MARKET EMMA" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur "MARKET EMMA" sh.p.k . Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega . Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private "MARKET EMMA" sh.p.k do te kete seline ne adresën rruga" RREXHEP BASTARI" Ndërtesa nr. 3; H. 3; Ap. 14, Dajt, Linzë ,1040; TIRANË . Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të saj .


Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtëme :

- Tregtim me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore .
- Tregtim me shumicë dhe pakicë i produkteve bulmetore.
- Tregtim me shumicë dhe pakicë i produkteve te ndryshme , si duhan/cigare , detergjentë,,produkte të kujdessit personal, etj...

Kohëzgjatja e Shoqërisë



Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat . Ajo mund shpërbëhet në cdo kohë dhe për çfardo lloj shkak .

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqërisë private "MARKET EMMA" sh.p.k do të jetë 100.000 (Një qind mijë) lek e ndarë në 1 kuota

Kapitali i shoqërisë do të jetë i përbër si më poshtë :

- 100% nga kuotat e ortakut XHEMAL BAJRAM QARRI, 100.000 (një qind mijë) lek,

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakesohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga këshilli i ortakëve/ortaku i vetëm

Neni 7

Këshilli i ortakëve ka të drejtë që :

- të emërojë apo shkarkojë një apo disa Administratorë

Cdo emërim apo shkarkim i Administratorit merret me vendim të këshillit të ortakëve dhe vendimet paraqiten pranë QKB për të kryer ndryshimet përkatëse , duke respektuar ligjet në Republikën e Shqipërisë

- Ka të drejtë të caktojë financier/e , likuidator/e për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë .

Neni 8

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve dhe do të ndahen në bazë të kuotave të zotëruara ose në bazë të vendim-marrjes së mbledhjes së këshillit të ortakëve.


Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rethit Gjyqësor Tiranë .

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonëshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11



Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 12

Akti I themelimit u përpilua në 3 kopje , për t'ju shpërndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "MARKET EMMA" sh.p.k

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët, me vullnetin e tyre të lire.

Ortakët

Ortaku i vetëm

Xhemal Qarri

